

K o m e n t

Mbi dorezimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2025

Te nderuar te interesuar

Ne lidhje me afatet e dorezimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2025 **po rendisim:**

1. Ligji per Qendren Kombetare te Regjistrimit

- Ka detyrimin per dorezimin e PF, brenda 7 muajve nga data e mbylljes së vitit financiar
- Ka detyrimin per dorzimin e PF, çdo subjekt, që është i regjistruar

2. Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare

- Ka detyrimin per dorezimin e PF, njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit

3. Ligji per Tatimin mbi të Ardhurat

- Ka detyrimin per dorezimin e PF, brenda dates 31 mars

4. UMF per Tatimin mbi të Ardhurat

- Ka detyrimin per dorezimin e PF, pranë QKB dhe në sistemin *e-Tax* (nenkupto 31 korrik)

Duket sikur kemi nje mosperputhje me ligjin e Tatimit mbi te ardhurat

5. Per Pasqyrat financiare te mikronjesive

A. SKK 15

- **Ishte:** mikronjësitë **që realizojnë jo më pak se 5 milion** lekë
- **Behet:** mikronjesite sipas ligjit per kontabilitetin aktivi 15 ml,xhiro 30 ml,punonjes 10

B. UMF per Tatimin mbi të Ardhurat

- Mikronjësitë me xhiro më pak se 5 milionë lekë, s'kanë detyrim për pasqyrat financiare
- Udhëzimi MF i referohet SKK te shfuqizuar nga Urdheri MF qe ne vitin 2022**

Konkluzioni:

- Pasqyrat financiare do te dorezohen ne DPT dhe ne QKB njelloj si deri me sot
- Çdo insinuate e kundert eshte e pa bazuar dhe mund te shoqerohet me penalitete

Luan Gosnishti
Auditues Ligjor

VO; Me poshte eshte kuadri ligjor i plote i siper cituar.

Ofrimi per qellime informimi i ketij materiali ligjor, botuar ne fletoren zyrtare te siperpermendur, mundesohet nga Gosnishti Auditors and Partners



Ligji 9723 date 03.05.2007
Per Qendren Kombetare te Regjistrimit

Neni 22 Detyrimi për regjistrim

1. Subjektet që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar janë:

a) subjektet tregtare;

.....

5. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme

1. Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistrin,

2.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

Neni 46 Regjistrimi i pasqyrave financiare

1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

Ligji 25/2018 date 10.05.2018
Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare

Neni 4 Kategoritë e njësive ekonomike dhe grupeve

1. Në zbatim të këtij ligji, në varësi të kriterëve që përmbushin, njësitë ekonomike klasifikohen në:

1.1. Mikronjësi ekonomike - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme:

a) aktiv, 15 milionë lekë;

b) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), 30 milionë lekë;

c) numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese, 10.

Neni 22 Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare

1. Njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 23 Përgjegjësitë

3. Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.

Standardi 15

“Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të Mikronjësive Ekonomike” i përmirësuar

(I ndryshuar Janar 2022 dhe miratuar me Urdherin e MF Nr.165 date 13.06.2022 botuar me gjithë SKK 15 të ndryshuar në FZ 109/2022 dhe publikuar me 01.08.2022)

FUSHA E ZBATIMIT

Ishte

5. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha mikronjësitë ekonomike që realizojnë jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion lekë të ardhura nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi).

Behet

5. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitet ekonomike të klasifikuara mikronjesi nga ligji 25/2018.”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM Nr. 26, datë 8.9.2023

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 4, datë 4.2.2025; nr. 24, datë 6.11.2025)

(i përditësuar)

61. Deklarata tatimore vjetore

61.6 Deklarimi nga tatimpaguesit realizohet sipas përcaktimeve në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij. Dorëzimi i deklaratës bëhet në rrugë elektronike, sipas formularëve përkatës të deklarimit, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

.....

Tatimpaguesit të cilët janë të detyruar të mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” paraqesin pranë administratës tatimore deklaratën tatimore, ndërsa pasqyrat e raportimit financiar i paraqesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin e fushës, si dhe në sistemin e-Tax.

.....

Bazuar në Standardin 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikro njësive ekonomike”, mikronjësitë ekonomike që realizojnë qarkullim më pak se 5 milionë lekë, nuk kanë detyrim për të mbajtur dhe raportuar pasqyrat financiare por mbajnë dokumentacion të thjeshtuar të aktivitetit të tyre tregtar, sipas afatit të parashikuar në Standardin 15.(Shtuar me UMF Nr.4 date 04.02.2025)

Kjo pjese e udhezimit i referohet SKK 15 te shfuqizuar pasi ky standart eshte ndryshuar ne janar 2022 dhe miratuar me Urdherin e MF Nr.165 date 13.06.2022 botuar me gjithë SKK 15 te ndryshuar ne FZ 109/2022 dhe publikuar me 01.08.2022

Ligj 29/2023 Date 30.03.2023
Per Tatimin mbi të Ardthurat

Neni 61
Deklarata tatimore vjetore

2. **Deklarata tatimore vjetore** dorëzohet në organin tatimor **jo më vonë se data 31 mars** e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, **paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare**, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.
